

LIGJ
Nr.9856, datë 26.12.2007

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7928, DATË 27.4.1995
"PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 24 "Organizatat jofitimprurëse", shkronjat "a", "b" dhe "c" shfuqizohen.

Neni 2

Neni 24/1 shfuqizohet.

Neni 3

Neni 25/2 "Barnat e pajisjet mjekësore" ndryshohet si më poshtë:

"Neni 25/2

Furnizimi i barnave dhe i ambalazheve e materialeve, që përdoren për prodhimin dhe konfeksionin e barnave, janë furnizime të përjashtuara."

Neni 4

Në nenin 26 pika 2.1. ndryshohet si më poshtë:

"2.1. Për makineritë dhe pajisjet e importuara nga personat e tatueshëm, në kuptim të këtij ligji, në funksion të veprimtarisë së tyre ekonomike, pavarësisht llojit të saj, zbatohet skema e shtyrjes së pagesës së TVSH-së deri në 12 muaj. Sipas kësaj skeme, TVSH-ja nuk paguhet në doganë në çastin e importit.

Këshilli i Ministrave përcakton me udhëzim skemën e shtyrjes së pagesës."

Neni 5

Në nenin 26/1 shkronja "a" ndryshohet si më poshtë:

"a) importimi përfundimtar i të gjitha mallrave prej një personi të tatueshëm, kur furnizimi i tyre, në të gjitha rrethanat brenda vendit, është i përjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar. Kjo shkronjë nuk zbatohet për furnizimin në import të periodikëve, revistave, shtypshkrimeve dhe librave të çdo lloji."

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5584, datë 18.1.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi